

AKTI I THEMELIMIT

PËR SHOQËRINË “RINORA” SHPK

FORMIMI I SHOQËRISË

Sot në Ure Vajgurore(Dimal) në datën 15 Shtator 2023 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar “**RINORA**” shpk, me vullnetin e lirë të ortakëve:

1.Rakip Belishaku, shtetas Shqipëtar, i biri i Shabanit, i datëlindjes 28.03.1994 lindur në Berat dhe banues ne Kuç,Rruga Stavri; Nd. 068; Poshnje; 5021; Ura Vajgurore, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr personal ID J40328003C.

2.Ina Fasko, shtetase Shqipëtare, e bija e Bardhylit, e datëlindjes 21.12.1995 lindur në Fier dhe banuese në Kuç,Rruga Stavri; Nd. 068; Poshnje; 5021; Ura Vajgurore, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr personal ID J56221012W.

SELIA E SHOQERISE

Shoqëria tregëtare " **RINORA** " SHPK., ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në Bashkine Ura Vajgurore (Dimal), Njësia Administrative Poshnjë, Fshati Kuç, Lagjja" Qëndër", rruga Stavri, zona kadastrale 2301, numri i pasurisë 77/1.

Me vendim të ortakëve të shoqërisë , mund të ngrihen edhe filiale, degë apo dhe seli përfaqësimi në vende të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

1. Shoqëria Tregtare “**RINORA**” SHPK., do të përmbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.

Ndryshimet e shoqërisë duke përfshire edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100 lekë (Njeqind leke), i cili është tërësisht kapital financiar Kapitali themeltar është i ndarë në 2 (dy) kuota,ku njera kategori me vlerë nominale 51 lekë (pesedhjetë e nje leke) dhe kuota tjetër 49 (dyzet e nente leke).

Kapitali themeltar zotërohet nga:

1. Rakip Belishaku, zotërues i 1 (një) kuote apo 51 % të kapitalit të shoqërisë me vlere 51 lekë (pesedhjetë e nje leke)

Ortaku kanë të drejtë të tjetërsojne, të zmadhojne apo të pakësojnë kuotat e kapitalit deri në kufinjtë e përcaktuara nga ligji.

2. Ina Fasko, zotërues i 1 (një) kuote apo 49% të kapitalit të shoqërisë me vlere 49 (dyzet e nente leke).

Ortaku kanë të drejtë të tjetërsojne, të zmadhojne apo të pakësojnë kuotat e kapitalit deri në kufinjtë e përcaktuara nga ligji.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË:

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “RINORA” shpk do të jetë :

Zhvillimi i teknologjive në fushën e informacionit, platforma online. Shërbime konsulence dhe marketingu. Kultivimi i bimëve aromatike dhe sfungjerit luffa. Prodhimi artizanal i produkteve si sfungjer luffa, sapune, kremra, import-eksport, furnizim, distribucion.

Me zgjerimin e aktivitetit shoqëria mund të bëjë shtesa të ndryshme ose ndryshime të objektit të veprimtarisë së saj duke bërë ndryshimet përkatëse në statut.

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

1. Organi drejtues i shoqërisë është asambleja e përgjithshme e ortakëve e cila është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështje të mëposhtme :

a- për ndryshime në statut

b- emërimin dhe shkarkimin e administratorit

c- miratimin e bilancit dhe të pasqyrave financiare vjetore.

d- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit

e- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Administratori i përgjithshëm i shoqërisë, është **Rakip Belishaku** me afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

BAZA LIGJORE

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 datë 14.04.2008” Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare “ si dhe në legjislacionin në përgjithësi të Republikës së Shqipërisë.

Ky Akt Themelimi u nënshkrua në tre kopje të barasvlefshme të tij.

Njëri prej tyre ruhet në selinë e shoqërisë.

ORTAKET:

Rakip Belishaku



Ina Fasko

